



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Komisioni i Pranimit për Institucionet e Administratës Shtetërore për Grupin: Specialist i Arsimit, Grupi Nr. 49

Nr. 1505 /2023
Datë: 22.09.2023

Komisioni i Pranimit për Institucionet e Administratës Shtetërore për Grupin: Specialist i Arsimit, Grupi Nr. 49, i themeluar me Vendimin Nr. 05/151, të datës 12.07.2023, e në mbështetje të nenit 99 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, neni 34 paragrafi 12 i Ligjit Nr.06/L/114 për Zyrtarët Publikë si dhe nenit 17 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, me datë 22.09.2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

Për shtyrje të afatit për shqyrtimin e ankesave në procedurën e konkurrimit për pozitën Inspektorë të Arsimit

Shtyhet afati edhe për shtatë (7) ditë kalendarike për shqyrtimin e ankesave në procedurën e konkurrimit për Inspektorë të Arsimit të shpallur me datë: 05.05.2023 nga Ministria e Punëve të Brendshme/Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë me nr. ref: RN00011607, RN00011608, RN00011609, RN00011610, RN00011611, RN00011612, RN00011613.

II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Komisioni i Pranimit për Institucionet e Administratës Shtetërore për Grupin Specialist i Arsimit, Grupi nr. 49, ka pranuar një numër të madh të ankesave nga kandidatët për vlerësimin e testit me shkrim, biografisë dhe intervistës me gojë.

Andaj, duke ditur që brenda afatit prej shtatë ditëve është e pamundur shqyrtimi dhe nxjerrja e vendimeve lidhur me ankesat e kandidatëve, Komisioni i Pranimit në pajtim me nenin 99 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative vendosi shtyrjen e afatit edhe për shtatë (7) ditë kalendarike për shqyrtimin e ankesave.

Andaj, nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Zade Kuqi
Kryesuesja e Komisionit të Pranimit
për Grupin Nr.49, Specialist i Arsimit